

**TESTI PROFESIONAL
E DREJTA CIVILE
TEZA 5**

I. Jepni përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

a. Çfarë është kushti penal?

Kushti penal vendoset nga palët në kontratë që ka si qëllim riparimin e dëmit ose nxitjen e ekzekutimit të detyrimit. Kushti penal parashikohet në formën e një shume të hollash ose një detyrimi tjetër që përdoret si mjet për të siguruar ekzekutimin e plotë ose ekzekutimin jo në mënyrën e duhur të detyrimit.

b. Kur lind nevoja që të interpretohet një kontratë dhe ku konsiston interpretimi i kontratës?

Interpretimi nevojitet në rastet kur fjalët, shprehjet ose kushtet e kontratës, mund të merren me dy kuptime, mund të jenë të errëta ose të paqarta. Në këto raste duhet të sqarohet se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës. Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët dhe kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit, në mënyrë që të kenë efekt.

c) Cili veprim juridik quhet fiktiv ose i simuluar?

Veprim juridik fiktiv ose i simuluar quhet veprimi që bëhet me marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellë pasoja juridike. Palët kontraktuese krijojnë vetëm anën e jashtme të një kontrate për të cilën ata nuk duan të ketë efekt ose krijojnë anën e jashtme të një kontrate të ndryshme nga ajo që dëshirojnë. Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre. Veprimi juridik fiktiv ose i simuluar nuk dëmton personat e tretë të cilët në mirëbesim kanë fituar të drejta në bazë të tij.

(10 pikë=3+3+4 pikë)



II. Ku dallon padia e kthimit të sendit nga padia mohuese?

Padia mohuese ngrihet vetëm nga pronari kundër cilido që e cenon në pronësinë e tij. Padia e kthimit të sendit ngrihet vetëm nga pronari kundrejt çdo poseduesi (I paligjshëm) në mirëbesim ose keqbesim, ose mbajtësi. Po ashtu, kjo padi ngrihet edhe nga bashkëpronari për sendin e përbashkët, me qëllim që ai t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve.

Në padinë e kërimit të sendit, pronari është zhveshur nga posedimi, ndërsa në padinë mohuese, pronari nuk është zhveshur nga posedimi, por cënohet në gëzimin e qetë të pasurisë së tij.

Në padinë mohuese pronari ka të drejtë të kërkojë pushimin e cenimit dhe mospërsëritjen e tij në të ardhmen, dhe, kur është rasti, ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që mund t'i jetë shkaktuar. Ndërsa në padinë e kërimit të sendit pronari ka të drejtë të kërkojë kthimin e sendit dhe shpërblimin e përdorimit të sendit.

Në padinë e kërimit të sendit poseduesi me mirëbesim i mban frutat e sendit (frutat natyrore të vecuara dhe ato civile) deri në momentin që erdhi në dijeni se është posedues I paligjshëm ose I është njoftuar padia për kërkimin e sendit. Ai ka të drejtë të kërkojë shpenzimet e nevojshme të bëra për sendin dhe të dobishme në masën që I kanë rritur vlerën sendin. Ndërsa poseduesi me keqbesim kthen sendin me gjithë frutat (natyrore e civile) dhe ka të drejtë të kërkojë shpenzimet e nevojshme. Kjo situatë është karakteristike vetëm për padinë e kërimit të sendit dhe jo për padinë mohuese. **(10 pikë)**

III. Cilat janë arsyet praktike të institutit të përfaqësimit dhe si zgjidhen pasojat e përfaqësimit pa tagra.

Pamundësia për t'i kryer vetë personalisht veprimet juridike ka çuar në krijimin e institutit të përfaqësimit. Kjo pamundësi mund të jetë objektive për shkak të: mosndodhjes së personit në dy vende të ndryshme në të njëjtën kohë; nevojës për të kryer një numër të madh veprimesh juridike dhe pamundësisë për t'i realizuar vetë ato; pamundësisë objektive për të qënë i pranishëm fizikisht për shkak izolimi, gjendje shëndetësore, mungesës së zotësisë për të vepruar, apo pengese tjetër; ose mungesës së njohurive të thelluara në kryerjen e veprimeve juridike.

Përfaqësuesi kryen veprime juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, brenda tagrave që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata. Përfaqësimi pa tagra ndodh në rastet kur



një person vepron si përfaqësues, pa e patur këtë cilesi, ose kur vepron duke kapërcyer targa që i janë dhënë.

Veprimi juridik i kryer në këto kushte nuk është i detyrueshëm për personin në emrin e të cilit janë kryer, përveçse kur i përfaqësuar i ka miratuar ato më vonë. Kur miratimi nuk është dhënë, personi i tretë në mirëbesim, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të pësuar, nga personi që ka vepruar si përfaqësues pa tagra. **(15 pikë)**

IV. Analizoni situatën e mëposhtme dhe përgjigjuni pyetjeve të shtruarat:

Shoqëria tregëtare A ka kryer punime ndërtimore (asfaltim rruge) bazuar në kontratën e sipërmarrjes të lidhur me shoqërinë tregtare B. Shoqëria B është në vonesë kundrejt shoqërisë A për pagimin e shpërblimit për punën e kryer prej saj.

Gjatë periudhës së vonesës administratori i shoqërisë B (pala debitore) i drejtohet ekonomistit të tij me anë të një kërkesë në të cilën parashtrohet: “Kryej të gjithë analizën tekniko-financiare dhe përcakto vlerën e detyrimit që kemi ndaj shoqërisë A”.

Gjatë gjykimit të padisë me palë paditëse shoqërinë A, kundrejt të paditurit shoqëria B me objekt “Detyrimin e shoqërisë B të përmbushë detyrimin kontraktor në lidhje me pagesën e shpërblimit për punën e kryer” u pretendua se paditësit i është parashkruar e drejta e padisë.

Pyetje:

Në pozitat e gjyqtarit argumentoni nëse kërkesa që administratori i shoqërisë B i drejton ekonomistit të tij përbën shkak për ndërprerjen e afatit të parashkrimit të padisë?

Shkaqet e ndërprerjes së afatit të parashkrimit të padisë parashikohen shprehimisht në Kodin Civil. Në nenin 131/a të KC thuhet se parashkrimi ndërpritet me cdo veprim të personit të detyruar që shpreh njohjen e saktë dhe të plotë të së drejtës së kreditorit sipas kushteve të mëposhtme:

- a) veprimi i njëanshëm i debitorit për njohjen e detyrimit realizohet përpara përfundimit të afatit të parashkrimit të padisë;
- b) njohja dhe pranimi i detyrimit i kundërdrejtohet kreditorit;
- c) detyrimi njihet në mënyrë të plotë, të qartë dhe të saktë nga ana e debitorit.

Komunikimi shkresor i administratorit të shoqërisë B (*shoqëria debitore*) me ekonomistin e saj, ku i kërkohet analiza tekniko – financiare dhe përcaktimi i detyrimit kundrejt shoqërisë A nuk përbën shkak për ndërprerjen e afatit të parashkrimit të padisë, sepse:

Së pari, nga kërkesa është lehtësisht e konstatueshme se mungon shprehja e vullnetit të debitorit për pranimin e ekzistencës së detyrimit monetar ndaj shoqërisë A.

Së dyti, detyrimi i kërkueshëm nga pala kreditore, jo vetëm nuk është njohur në mënyrë të plotë dhe të saktë nga shoqëria B, por administratori i debitorit ka paqartësi të plotë në raport me vlerën e detyrimit, ndaj ka angazhuar ekonomistin për përcaktimin e shumës së detyrimit.

Së treti, veprimi i administratorit të shoqërisë B nuk i kundërdrejtohet kreditorit, por është një komunikim i brendshëm me strukturat e shoqërisë së tij për nevoja të analizës së detyrimit dhe përputhjes së tij me vlerën e pretenduar nga shoqëria kreditore A.

(15 pikë)

